

VENDIM
Nr. 66/2022

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR “PËR
HARTIMIN E SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË LIGJIN NR. 15/2015,
‘PËR ROLIN E KUVENDIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË NË BASHKIMIN EVROPIAN”**

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, dhe 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 24 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për hartimin e shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.”.

II. Komisioni ka objekt të veprimtarisë së tij hartimin e shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”.

III. Anëtarësia e Komisionit përbëhet nga përfaqësues të partive politike parlamentare, me përbërje të barabartë mes shumicës dhe pakicës.

IV. Komisioni drejtohet nga dy bashkëkryetarë, një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike.

V. Përbërja e Komisionit është, si më poshtë:

1. Taulant Balla	bashkëkryetar	(PS)
2. Jorida Tabaku	bashkëkryetare	(PD)
3. Etilda Gjonaj	anëtare	(PS)
4. Toni Gogu	anëtar	(PS)
5. Gerta Duraku	anëtare	(PS)
6. Kreshnik Çollaku	anëtar	(PD)
7. Mesila Doda	anëtare	(Demokraci dhe Integrim)
8. Fatmir Mediu	anëtar	(Aleanca për Ndryshim)

VI. Çdo parti që përfaqësohet në komision ka të drejtë të propozojë amendamente për diskutim dhe miratim. Palët duhet të angazhohen dhe të gjejnë konsensusin në lidhje me to.

VII. Mbledhjet e Komisionit janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit. Vendimmarrja e Komisionit synon konsensusin e gjerë për të gjitha propozimet. Vendimet e Komisionit konsiderohen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve, por vetëm kur kanë marrë njëkohësisht konsensusin e të dy bashkëkryetarëve.

VIII. Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat 2-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi. Në rast nevojë, me kërkesë të arsyetuar të bashkëkryetarëve, Kuvendi vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit me një vendim të veçantë të Kuvendit.

IX. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për krijimin e kushteve të punës, si dhe për mbështetjen me burime njerëzore, financiare dhe logjistike të veprimtarisë së Komisionit dhe të grupit të ekspertëve të ngritur pranë tij.

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 8.9.2022.